



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)

**Nr. 108**

**Datë 11 korrik 2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 41, datë 7.7.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2012-1449, datë 15.6.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	4189
Vendim i GJK nr. 42, datë 7.7.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 95, datë 23.4.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr.00-2012-2245, datë 1.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	4190
Vendim i GJK nr. 43, datë 7.7.2014	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm .....	4196

**VENDIM**  
**Nr. 41, datë 7.7.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“	
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	
Gani Dizdari	anëtar i	“	“	
Sokol Berberi	anëtar i	“	“	

me sekretare Edmira Babaj, në datën 22.4.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 14 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Vlash Piroli

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Vat Piroli, Pashke Piroli

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2012-1449, datë 15.6.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Vat Piroli dhe Pashke Piroli, që kërkojnë rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 179, datë 10.4.2001, ka vendosur rrëzimin e padisë së paraqitur nga kërkuari me objekt pavlefshmërinë e aktit të pronësisë nr. 50, datë 29.10.1993, në emër të subjektit të interesuar V.P.

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1045, datë 28.9.2001, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

3. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 733, datë 17.4.2003, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1045, datë 28.9.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në apo atë gjykatë, me trup tjetër gjyqësor.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 388, datë 26.3.2004, ka vendosur prishjen e vendimit nr.

179, datë 10.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin duke e kthyer çështjen për rigjykim në apo atë gjykatë, me trup tjetër gjyqësor.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 548, datë 18.7.2008, ka vendosur, ndër të tjera, rrëzimin e kundërpadisë së paraqitur nga kërkuari dhe detyrimin e tij t'i kthejë subjektit të interesuar V.P., sipërfaqen prej 15.000 m<sup>2</sup>, të përcaktuar në aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr. 50, datë 29.10.1993.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 817, datë 18.6.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1449, datë 15.6.2012, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari.

**II**

8. *Kërkuari* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Më konkretisht, ai ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr. 00-2012-1449, datë 15.6.2012, ka cenuar:

8.1 Standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi në të nuk janë pasqyruar shkaqet e ngritura nga kërkuari në rekurs dhe as arsyet e mospranimit të tij;

8.2 Të drejtën e aksesit në gjykatë për arsye se është vendosur mospranimi i rekursit edhe pse ai përmbante shkaqe për praninë dhe shqyrtim në seancë gjyqësore.

9. *Subjektet e interesuara*, Vat Piroli dhe Pashke Piroli, kanë prapësuar se:

9.1 Vendimi i Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar nga kërkuari, është i arsyetuar pasi nëpërmjet tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa shqyrtuar themelin e çështjes. Ky vendim është marrë në dhomën e këshillimit, ku Kolegji seleksionues shqyrton anën formale të rekursit dhe nëse shkaqet e ngritura përputhen me ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Kërkuari në rekurs nuk përmend se cilat janë shkaqet për të cilat kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit;

9.2. Pretendimi për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë është i pabazuar pasi mospranimi i rekursit është një ndër instrumentet procedurale që disponon Gjykata e Lartë që parashikohet edhe nga korpusi i dispozitave procedurale në fuqi.

**III**

**Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese**

*A. Për pretendimet e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtës së aksesit në gjykatë*

10. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar në lidhje me shkaqet e mospranimit të rekursit dhe në vendim nuk janë

parashtruar shkaqet e rekursit mbi bazën e të cilave ai ka kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Ai ka pretenduar gjithashtu se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë pasi edhe pse rekursi përmbante shkaqe për praninë, Kolegji seleksionues i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

11. Në lidhje me pretendimet e kërkuarit, Gjykata, gjatë votimit të çështjes, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj<sup>1</sup>, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuarit duhet të refuzohet. Sipas këtij neni, refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuari të riparaqesë kërkesën, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

#### VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Gani Dizdari

#### VENDIM

**Nr. 42, datë 7.7.2014**

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“ “
Sokol Berberi	anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“ “
Gani Dizdari	anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	anëtare	e	“ “

<sup>1</sup> Votuan për praninë e kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Sokol Berberi, Gani Dizdari dhe Fatmir Hoxha, ndërsa për rrëzimin e saj gjyqtarët: Vladimir Kristo, Vitore Tusha dhe Altina Xhoxhaj.

me sekretare Edmira Pacani, në datën 11.4.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 20 Akti, që i përket:

**KËRKUESE:** Edlira Nuredinaj

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Kristo Kamberaj

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimeve nr. 95, datë 23.4.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr.00-2012-2245, datë 1.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

**BAZA LIGJORE:** Nenet 41/1, 42/1, 43, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; nenet 7, 10, 13, 14, 28, 29 të Kodit të Procedurës Civile.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha; mori në shqyrtim pretendimet e paraqitura me shkrim nga kërkuarja, që kërkoi praninë e kërkesës; dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

##### I

1. Kërkuarja dhe subjekti i interesuar kanë qenë të martuar nga viti 1997 deri në vitin 2009 kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 271, datë 5.2.2009 ka vendosur zgjidhjen e martesës. Kërkuarja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, kërkesë e cila është pranuar me vendimin e fazës së parë të pjesëtimin nr. 1755 regj, datë 7.9.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që ka vendosur “... *lejimin e pjesëtimin të pasurisë së vënë gjatë martesës, duke caktuar në pjesë të barabarta nga ½ secili mbi sendet që përfshijnë: (1) një apartament me sipërfaqe 251.6 m<sup>2</sup> ; (2) një objekt banesë trikatëshe me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, kati i parë dyqan...*”.

2. Mbi ankimin e paraqitur nga subjekti i interesuar, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 95, datë 23.4.2010, ka vendosur *ndryshimin e vendimit të fazës së parë të pjesëtimin të pasurisë së përbashkët dhe, duke gjykuar çështjen në fakt, ka rrëzuar padinë e kërkuarjes.*

3. Kërkuarja ka depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 00-201-2245 ka vendosur *mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.*

##### II

4. **Kërkuarja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 20.1.2014, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, në aspektet e mëposhtme:

4.1. Është cenuar *parimi i paanësisë*, pasi gjykatat kanë favorizuar “më të fortin” e më të afërmin me ta, në shkelje edhe të parimit të barazisë.

4.2 Gjykata e Apelit Vlorë ka cenuar të drejtën e pronësisë duke zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material, konkretisht nenet 73, 74 dhe 76 të Kodit të Familjes, si dhe nenet 83, 92/e, 191, 231 të Kodit Civil. Ashtu siç pranohet edhe nga Gjykata e Apelit në arsyetimin e vendimit, sendet, objekt pjesëtimi, kanë qenë pasuri bashkëshortore, fakt që provohet nga aktet e lëshuara nga ZRPP-ja.

4.3 Deklarata noteriale nr. 60 rep., nr. 1053 kol., datë 21.7.2008 mbi heqjen dorë në mënyrë të njëanshme nga pronësia, e bërë në kushtet e dhunës dhe presionit psikologjik, jo vetëm është revokuar me një akt tjetër noterial, por deri në përfundim të procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit nuk është regjistruar në ZRPP. Ndonëse ky deklarim është i pavlefshëm, Gjykata e Apelit ka mbajtur qëndrim të kundërt, në shkelje të neneve 191 dhe 83 të KC-së.

4.4 Është cenuar *e drejta për t'iu drejtuar* Gjykatës së Lartë, pasi shkaqet e parashtruara në rekurs janë nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së dhe si të tilla duhet të ishin bërë objekt i shqyrtimit në seancë gjyqësore. Ndonëse fakte si cenimi i ligjit procedural nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe zgjidhja e çështjes mbi bazën e fakteve të administruara gjatë procesit gjyqësor ishin parashtruar edhe në rekurs, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

## II

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### A. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

5. Kërkuesja ka pretenduar se gjykatat kanë favorizuar palën që ka qenë më e fortë dhe më e afërt me ta, në shkelje edhe të parimit të barazisë dhe duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

6. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit

subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konstaton se kërkuesja nuk parashtron argumente kushtetuese në lidhje me mungesën e garancive procedurale të mjaftueshme nga gjykatat dhe as në lidhje me praninë e ndonjë interesi personal të gjyqtarëve në atë proces. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut nuk është ngritur në nivel kushtetues.

#### B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

9. Kërkuesja ka pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Lartë, nuk ka marrë parasysh pretendimet në lidhje me arsyetimin e gabuar të Gjykatës së Apelit mbi vlerën juridike të deklaratës noteriale të vitit 2008, përmes së cilës ka hequr dorë nga pasuria në bashkëpronësi, e më pas e ka revokuar, në kuptim të nenit 191 të Kodit Civil.

10. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata Kushtetuese ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "f" e Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por

identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006 dhe nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në këtë kuptim, Gjykata e ka vlerësuar si cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor rastin kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor ka pasur për objekt pjesëtimin e pasurisë së përbashkët midis bashkëshortëve, të cilët kanë rezultuar bashkëpronarë mbi pasuritë e vëna gjatë kohës së martesës. Deklaratat noteriale të lëshuara nga pala paditëse janë bërë objekt gjykimi si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ashtu dhe Gjykata e Apelit Vlorë, të cilat e kanë interpretuar në mënyra të ndryshme natyrën juridike të aktit dhe pasojat ligjore që vijnë në drejtim të humbjes së pronësisë si rezultat i heqjes dorë prej saj, referuar nenit 191 të KC-së.

15. Paditësja, duke pretenduar cenimin e të drejtës së pronësisë si rezultat i interpretimit të nenit 191 të KC-së nga Gjykata e Apelit Vlorë, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs duke kërkuar zgjidhjen e çështjes në ushtrimin e funksionit të interpretimit të ligjit, por Gjykata e Lartë ka vendosur, në dhomën e këshillimit, mospranimin e rekursit.

16. Gjykata rithekson se në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, kompetenca e saj për shqyrtimin e

çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile, kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 53, datë 9.12.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, kontrolli që ushtron Gjykata e Lartë duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Siç ka theksuar edhe më parë Gjykata, vlerësimi që kryen Gjykata e Lartë, në kuptim të neneve 472 dhe 485 të KPC-së, lidhet me çështjet që kanë të bëjnë me mosrespektimin e ligjit ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, ndaj provave të administruara në gjykimin e faktit dhe që i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Individualizimi i provave, të cilat përbëjnë burimin e bindjes së gjyqtarit, dhe administrimi i tyre janë çështje që i përkasin gjykimit të faktit dhe, si të tilla, ndajnë juridiksionin e atyre gjykatave nga ai i Gjykatës së Lartë si gjykatë e ligjit. Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por as nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit, t'i ndryshojë ato apo të arrijë në konkluzione për faktet e çështjes që bien në kundërshtim me përfundimet e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata rithekson se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimin nr. 4 datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në gjykim, nisur nga detyrimi që ka Gjykata e Lartë që rast pas rasti t'i japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit material, po edhe për shkak të natyrës të së drejtës së pretenduar, siç është e drejta e

pronësisë, Gjykata vlerëson se për sa kohë kërkuesja nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs, asaj i është mohuar e drejta e aksesit në kuptimin substancial, dhe, në këtë kuptim, pretendimi për cenimin e kësaj të drejte nga Gjykata e Lartë është i bazuar dhe duhet pranuar.

20. Në përfundim, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues dhe, për pasojë, vendimi duhet të shfuqizohet.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2012-2245, datë 1.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Gani Dizdari  
Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj

#### MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në çështjen me kërkuese Edlira Nuredinaj dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishëm të shprehem me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica është shprehur se në rastin në gjykim, nisur nga detyrimi që ka Gjykata e Lartë që rast pas rasti t’i japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit material, po edhe për shkak të natyrës së të drejtës së pretenduar, siç është e drejta e pronësisë, Gjykata vlerëson se për sa kohë kërkuesja nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs, asaj i është mohuar e drejta e aksesit në kuptimin substancial (*prg. 19 i vendimit*).

3. Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës pasi, në vlerësimin tim, ashtu siç jam shprehur edhe me mendim pakice në vendimet nr. 4, datë 5.2.2014 dhe nr.

3, datë 23.1.2014, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje kërkueses në vendimin e saj, të marrë në dhomë këshillimi. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012 dhe nr. 17, datë 17.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese; vendimin nr. 143, datë 7.12.2011, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

4. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” (...) “arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

5. Nga arsyetimi i shumicës nënkuptohet se, në rastin e ngritjes në rekurs të pretendimeve me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, kur nuk e pranon rekursin, duhet t’u japë përgjigje këtyre pretendimeve. Në një arsyetim *a contrario*, bazuar në qëndrimin e mësipërm, nëse në rekurs nuk ngrihen pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë nuk është e detyruar t’u japë përgjigje, pasi në këto raste është i mjaftueshëm një arsyetim i kufizuar, që e përmbush standardin kushtetues të arsyetimit. Ky lloj diferencimi në trajtimin e arsyetimit, i lidhur me natyrën e pretendimeve të ngritura në rekurs, është bërë nga shumica pa parashtruar motivet përse arsyetimi i kufizuar konsiderohet i rregullt, në aspektin kushtetues, në disa raste, dhe i parregullt në raste të tjera.

6. Me qëndrimin e saj shumica ka lënë shteg për një lloj ndërhyrjeje të Gjykatës Kushtetuese në rolin vlerësues të Gjykatës së Lartë. Kështu shumica, në rastin konkret, ka vlerësuar përmbajtjen e rekursit, konkretisht duke identifikuar natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura në të dhe duke i imponuar Gjykatës së Lartë argumentimin në lidhje me këto pretendime. Vlerësimi i rekursit është atribut i Gjykatës së Lartë, e cila vlerëson pretendimet e ngritura në rekurs, në dhomë këshillimi. Vlerësimi i procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në këndvështrim të respektimit të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të bëhet nga Gjykata gjithmonë brenda kuadrit të kompetencave të saj, çka përjashton vlerësimin e përmbajtjes së rekursit dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të ndjekur mënyra të ndryshme për vlerësimin e pretendimeve.

7. Gjithashtu, me qëndrimin e saj shumica krijon paqartësi për sa i përket mundësisë që ka kërkuesi për ta goditur për antikushtetutshmëri të njëjtin vendim pas rigjykimit në Gjykatën e Lartë. Në rastin konkret shumica i është shmangur vlerësimin kushtetues të pretendimeve që, në çmuarjen e saj, kanë natyrë kushtetuese, duke e rikthyer çështjen në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, qëndrimi i shumicës nuk i shërben efektivitetit të shqyrtimit kushtetues dhe respektimit të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

8. Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmtoj se në rastin konkret nuk është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj kërkesa e paraqitur nga kërkuesja duhet të ishte rrëzuar.

Anëtar: Sokol Berberi

#### MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese Edlira Nuredinaj, jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2012-2245, datë 1.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe, për pasojë, dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

2. Neni 472 i KPC-së ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, kurse neni 480 i po këtij Kodi parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i rekursit vendoset nga kolegji në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencë konstante, Gjykata ka theksuar se, në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij

të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 8, datë 2.5.2006; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 4, datë 25.2.2009; nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në kuptim të sa më sipër, jurisprudenca e Gjykatës ka ecur në linjën që një vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit, cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit, në një nga elementet përbërëse të saj, e cila është e vetmja e drejtë kushtetuese procedurale që i lejon individit të mbrojtë të drejtat e tjera të tij substanciale. Në rast të evidentimit të një cenimi të tillë, të konstatuar në shkallët e tjera të gjykimit, Gjykata, në zbatim të parimit të subsidiaritetit e ka kthyer çështjen në Gjykatën e Lartë në mënyrë që vetë ajo gjykatë, në funksion të pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, të mund të riparojë shkeljet e kryera brenda sistemit gjyqësor. Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbajë qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga individët për cenimin e një prej standardeve të procesit të rregullt, të evidentuar në gjykimin e faktit. Por, në rastet kur Gjykata nuk konstaton cenimin e së drejtës për proces të

rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tre shkallët e gjykimit, ajo nuk vë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se ai ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

5. Bazuar në konsideratat e mësipërme, vlerësoj se në rastin konkret, Gjykata nuk duhej të shfuqizonte vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

6. Shumica ka vlerësuar se kërkuesja, duke pretenduar cenimin e të drejtës së pronësisë si rezultat i interpretimit të nenit 191 të KC-së nga Gjykata e Apelit Vlorë, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs, për zgjidhjen e çështjes në ushtrimin e funksionit të interpretimit të ligjit. Më tej, duke analizuar kompetencat dhe rolin e Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji, shumica ka theksuar se ajo Gjykatë *“i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura. Në rastin në gjykim, nisur nga detyrimi që ka Gjykata e Lartë që, rast pas rasti, t'i japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit material, po edhe për shkak të natyrës së të drejtës së pretenduar, siç është e drejta e pronësisë, Gjykata vlerëson se për sa kohë kërkuesja nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs, asaj i është mohuar e drejta e aksesit në kuptimin substancial, dhe, në këtë kuptim, pretendimi për cenimin e kësaj të drejte nga Gjykata e Lartë është i bazuar dhe duhet pranuar”* (shih paragrafët 15-19 të vendimit).

7. Zbatimi dhe interpretimi i normës ligjore është së pari, dhe mbi të gjitha, funksioni kryesor i gjykatës që gjykon çështjen konkrete. Sistemi gjyqësor njeh disa shkallë gjykimi, me qëllim që shkeljet e kryera nga një gjykatë, procedurale apo materiale, të riparohen në një gjykatë më të lartë. Në këtë kuptim KPC-ja ka parashikuar, në nenin 466 të saj, se në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit mund të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ta ndryshojë atë, apo ta prishë dhe ta dërgojë për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, në rastet e parashikuara nga neni 467 i KPC-së. Gjatë shqyrtimit të çështjes, gjykata e apelit, si gjykatë e faktit, duke ushtruar të njëjtat kompetenca si gjykata e shkallës së parë, por në ushtrim edhe të funksionit të kontrollit ndaj atij vendimi, mund të bëjë edhe interpretime të ndryshme të ligjit të zbatueshëm, mbi faktet e çështjes konkrete, duke arritur edhe në një përfundim të ndryshëm lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

8. Për sa i përket Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, kompetenca e saj është të vlerësojë dhe sigurojë

zbatimin uniform të ligjit. Por kjo nuk nënkupton që në të gjitha rastet kur dy gjykatat e faktit kanë bërë një interpretim të ndryshëm të ligjit, Gjykata e Lartë ka detyrimin që të shprehet lidhur me mënyrën se si ai ligj i zbatueshëm duhet të interpretohet. Në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Për këtë arsye, shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë, nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por ai konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave e bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Po ashtu, nëse Kolegji i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se interpretimi që ka bërë gjykata e apelit, i cili është ai që kundërshtohet në rekurs, është i drejtë, është në kompetencën e tij të vendosë mospranimin e rekursit. Kjo është edhe përgjigja që i jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët.

9. Çdo qëndrim i kundërt do të vinte ndesh me qëllimin e ligjit për karakterin seleksionues të dhomës së këshillimit, për të kaluar në seancë vetëm ato çështje kur me të vërtetë në rekurs janë ngritur probleme ligjore. Për këtë arsye, vlerësimet që bën kolegji në dhomën e këshillimit, nuk mund të përbëjnë *a priori* proces të parregullt ligjor dhe të passjellin kurdoherë shfuqizimin e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese. Një qëndrim i tillë është në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave kushtetuese dhe do ta kthente padrejtësisht Gjykatën Kushtetuese në një instancë më të lartë gjykimi (*shih vendimin nr. 210, datë 27.12.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Vlerësimi i ekzistencës së shkaqeve ligjore në rekurs është kompetencë e dhomës së këshillimit dhe nuk mund të bëhet kurrsesi objekt i vlerësimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Vlerësimi lidhur me mënyrën se si është interpretuar deklarata noteriale e kërkueses, për heqjen dorë nga pasuria, është një çështje që nuk hyn në juridiksion kushtetues, ndaj i vetmi organ që ka kompetencën për t'u shprehur lidhur me pretendimin e ngritur nga kërkuesja është Gjykata e Lartë, çka ajo e ka bërë, në rastin konkret, nëpërmjet vendimit të dhënë në dhomën e këshillimit.

10. Bazuar në standardet e mësipërme vlerësoj se, edhe në rastin konkret, për sa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, kjo do të thotë se shkaqet e ngritura në të nga kërkuesja, që janë paraqitur si shkaqe ligjore për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, nuk gjejnë mbështetje as në ligj dhe as në materialet e çështjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë,



duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, ka realizuar një proces vlerësimi të atyre shkaqeve, nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv, për mospranimin e tij. Fakti që kërkuësja e lidh pretendimin e saj me të drejtën e pronësisë, nuk e legjitimon Gjykatën të shfuqizojë vendimin e Gjykatës së Lartë, për sa kohë që nuk ka mundur të evidentojë, ajo vetë, cenimin e standardeve të procesit të rregullt, apo qoftë edhe të kësaj të drejte substanciale të individit, të pretenduar të cenuar (e drejta e pronësisë).

11. Në këto kushte, vlerësoj se pretendimet e paraqitura në kërkesë janë të pabazuar dhe se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

**VENDIM**  
**Nr. 43, datë 7.7.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“	“
Gani Dizdari	anëtar	i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar	i	“	“
Fatos Lulo	anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	anëtare	e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 19.5.2014 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me bazë dokumentesh çështjen nr. 21 Akti, që i përket:

**KËRKUESE:** SHOQËRIA “Klame” sh.p.k.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Kuvendi i Shqipërisë, zyra përmbarimore private “Anastas Kote”

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar Kuvendi i Shqipërisë, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuësi, shoqëria “Klame” sh.p.k. ofron shërbime në fushën e prodhim drurit dhe mobilimit. Në datën 24.11.2009 kërkuësi, pas kryerjes së një procedure prokurimi, ka lidhur kontratën e furnizimit nr. 34/8 prot. me Kuvendin e Shqipërisë, me objekt shitblerjen e disa pajisjeve kompjuterike. Autoriteti kontraktor (Kuvendi), për shkak të disa vonesave në përmbushjen e detyrimit nga kërkuësi, e ka shtyrë afatin e kontratës deri në datën 11.2.2010, duke e njoftuar kërkuësin me shkresën nr. 221 prot., datë 26.1.2010, për të cilën ai ka marrë dijeni në datën 27.1.2010.

2. Në datën e fundit të afatit shtesë, kërkuësi ka paraqitur pjesën e mallrave të mbetura pa dorëzuar, duke njoftuar edhe zyrtarisht autoritetin kontraktor për mbërritjen dhe për krijimin e kushteve për magazinimin e tyre. Në po atë datë, Kuvendi ka deklaruar ndërprerjen në mënyrë të njëanshme të marrëdhënies kontraktore për mosplotësimin në kohë dhe me cilësi të kushteve të kontratës dhe, gjithashtu, ka kërkuar sekuestrimin e sigurimit të saj në shoqërinë e sigurimeve “Sigal Unica Group Austria” sh.a., po ashtu, Kuvendi, me cilësinë e autoritetit kontraktor, i ka kërkuar Agjencisë së Prokurimit Publik përjashtimin e kërkuësit për tri vjet radhazi nga prokurimet publike.

3. Në këto kushte, kërkuësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesëpadi me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së furnizimit nr. 34/8, datë 24.11.2009 nga i padituri. Detyrimi i palës së paditur t’i kthejë paditësit shumën e sekuestruar të sigurimit të kontratës në masën 886.080 lekë.”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1131, datë 10.2.2012, ka vendosur: “Pranimin e kërkesë padisë, konstatimin e pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së furnizimit; detyrimin e të paditurit Kuvendi i Shqipërisë, t’i kthejë shoqërisë “Klame” sh.p.k. shumën e sekuestruar të sigurimit të kontratës.”

4. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë dhe Avokatura e Shtetit, kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. 698, datë 20.3.2013 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

5. Kërkuësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, e cila është pranuar me vendimin nr. 3287 Akti, datë 17.5.2013 të asaj gjykate.

6. Në datën 27.5.2013 kërkuësi i është drejtuar zyrës përmbarimore private “Anastas Kote” Tiranë për marrjen e masave për bllokimin e fondit dhe shlyerjen e tij. Po në atë datë, përmbaruesi gjyqësor privat me shkresën nr. 337 prot. i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë lajmërim për ekzekutim vullnetar.

7. Në datën 10.6.2013 përmbaruesi gjyqësor privat i është drejtuar degës së Thesarit me shkresën nr. 385

prot për vendosjen e sekuestros konservative në llogarinë e thesarit, artikulli buxhetor 602 i Kuvendit të Shqipërisë në shumën 967.546 lekë. Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit, dega Tiranë, me urdhrin e brendshëm të datës 10.7.2013 ka urdhëruar bllokimin e fondeve buxhetore në favor të kreditorit “Klame” sh.p.k. në shumën e kërkuar.

8. Në datën 25.9.2013 Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, me shkresën nr. 1486/1 ka vënë në dijeni përmbuesin gjyqësor privat për shlyerjen e kështit të parë prej 200.000 lekësh. Po ashtu, përmes kësaj shkrese, përmbuesi njoftohet se urdhri për ekzekutimin e pjesëshëm në llogari të thesarit të detyrimit të përcaktuar në vendimin gjyqësor, është dhënë që në datën 19.9.2013.

9. Kërkuesi i është drejtuar gjithashtu Ministrisë të Drejtësisë dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

## II

10. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 24.2.2014 duke pretenduar konstatimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit tërësisht të vendimit të formës së prerë. Sipas tij, nga data 17.5.2013 deri në momentin që ai ka paraqitur ankimin kushtetues, Kuvendi dhe zyra përmbushur nuk kanë marrë masat e nevojshme për të përmbushur plotësisht detyrimet që burojnë nga vendimi gjyqësor i formës së prerë.

11. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, i ka prapësuar pretendimet e kërkuesit, duke argumentuar se shumica e detyrimit ndaj shoqërisë “Klame” sh.p.k. është shlyer tërësisht, pasi kësti i fundit është paguar në datën 22.4.2014. I vetmi detyrim që ka mbetur i papaguar është pagimi kundrejt shërbimit përmbushur i shumës prej 54.766 lekë, pasi janë në pritje të paraqitjes së faturave nga ky shërbim.

12. **Subjekti i interesuar, zyra përmbushur private “Anastas Kote”**, ka parashtruar në mënyrë të përmblodhur se janë përdorur të gjitha mjetet procedurale për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Fillimisht është dërguar lajmërimi për ekzekutim vullnetar, që ka vijuar më pas me ekzekutimin e detyrueshëm dhe vënien e sekuestros mbi llogaritë e Kuvendit. Po ashtu, është vendosur edhe gjobë ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, masë e cila është revokuar më pas si rrjedhojë e paraqitjes së dokumentacionit që provonte përmbushjen e një pjese të detyrimit nga pala debitore.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj është shprehur se personat juridikë, siç është edhe

kërkuesi, mund të jenë subjekte të të drejtave dhe lirive kushtetuese në nivel të kufizuar, “për atë sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve”, në kuptim të nenit 16, pika 2 e Kushtetutës. Disa nga këto liri dhe të drejta nuk është e mundur t’i atribuohen një personi juridik për shkak të thelbit të tyre, ose qëllimit për të cilin ligji i ka dhënë jetë personit juridik. Për sa u përket të drejtave të tjera, personi juridik mund të jetë subjekt i tyre në atë masë dhe në atë kuptim që ato lehtësojnë gëzimin e plotë të këtyre të drejtave dhe lirive për individët (*shih vendimin nr. 19, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vlerësimin e çështjes së legjitimitimit të personave juridikë për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetuese, Gjykata bazohet në të njëjtat elemente që merren në konsideratë për legjitimitimin e individëve, në kuptim të neneve 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” dhe pika 2 të Kushtetutës. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se pretendimet e kërkuesit lidhen me mosekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Këto pretendime janë trajtuar nga jurisprudenca kushtetuese si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 6, datë 31.3.2006; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Po ashtu, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtës së tij. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kërkuesi i është drejtuar subjektit të interesuar, i cili është organi kompetent për të përmbushur detyrimin e përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë.

16. Gjykata arrin në përfundimin se për sa kohë kërkuesi nuk ka mjet tjetër ligjor për konstatimin e cenimit të parimit të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në vështrim të standardeve të mësipërme dhe nga rrethanat e çështjes, shoqëria “Klame” sh.p.k. i përmbush kriteret në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, pasi pretendimet e saj përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; *ratione materiae*, pasi pretendimet e saj janë, *prima facie*, në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese; *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2 - vjeçar.

**B. Për pretendimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm**

17. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të

nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009, nr. 35, datë 27.10.2010, nr. 9, datë 27.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

19. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Sipas saj, kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit dhe autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

(i) *Në lidhje me kompleksitetin e çështjes*

20. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 7, datë 27.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përcaktuar detyrimin e Kuvendit për t'i kthyer shoqërisë "KLAME" sh.p.k. shumën e sekuestruar të sigurimit të kontratës prej 886.080 lekë. Për shkak të vënies në ekzekutim të këtij vendimi nga një shoqëri përmbarimore private,

shumës së detyrimit i është shtuar edhe 54.766 lekë, që përfaqëson tarifën e plotë të shërbimit 5 % mbi shumën totale plus 20 % TVSH. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se detyrimi në shumën totale prej 967.546 lekë është i identifikueshëm nga pikëpamja faktike dhe juridike.

22. Në kushtet kur dispozitivi i vendimit gjyqësor, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, është i qartë dhe i përcaktueshëm dhe, po ashtu, të tilla janë edhe kushtet e kontratës së shërbimit me shoqërinë përmbarimore, Gjykata çmon se nuk rezultojnë ndonjë paqartësi në dispozitivin e vendimit të formës së prerë mbi përcaktueshmërinë e detyrimeve financiare të debitorit kundrejt kreditorit në marrëdhënien kontraktore të furnizimit. Fakti që janë kryer disa pagesa të pjesshme nga debitori është tregues se edhe ekzekutimi i këtij detyrimi nuk paraqet vështirësi.

23. Nga sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta që mund të justifikojnë vonesën në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 698, datë 20.3.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga dita e marrjes së tij deri në realizimin e plotë të detyrimit ndaj kërkuarit.

(ii) *Në lidhje me sjelljen dhe interesin e kërkuarit*

24. Gjykata, në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke nënvizuar se përdorimi nga ana e kërkuarit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimet nr. 14, datë 15.04.2010, nr. 50 datë 22.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se sjella e kërkuarit përcaktohet nga qëndrimi i tij gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit. Në këtë kontekst, konstatohet se kërkuari, pasi vendimi nr. 698, datë 20.3.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë ka marrë formë të prerë, i është drejtuar shoqërisë përmbarimore duke lidhur kontratën e shërbimit në datën 27.5.2013.

26. Gjykata vlerëson se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e të drejtës së cenuar. Nga tërësia e fakteve dhe rrethanave, nuk rezultojnë që sjelljet e kërkuarit të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

(iii) *Në lidhje me sjelljen e autoriteteve*

27. Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010, vendimet nr. 7, datë 27.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Asnjë organ i administratës publike nuk mundet që duke ushtruar autoritetin e tij

publik, qoftë edhe për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik, të pengojë apo vonojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të dhënë në një gjykim në të cilin ai ka qenë palë. Përkundrazi, këto organe, si çdo subjekt tjetër palë e një gjykimi, kanë të drejtë që të kundërshtojnë në gjykatë ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor nëpërmjet ushtrimit të mjeteve mbrojtëse të parashikuara nga legjislacioni në fuqi (*shih vendimin nr. 42, datë 19.7.2012; nr. 20, datë 4.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në jurisprudencën e saj, Gjykata është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012, dhe nr. 2, datë 1.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në fazën e ekzekutimit të vendimeve marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 6, datë 4.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në lidhje me sjelljen e përmbaruesit gjyqësor privat, rezulton se kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor privat në datën 15.4.2013 dhe ka lidhur kontratën e shërbimit në datën 27.5.2013. Po në këtë datë, përmbaruesi i është drejtuar Kuvendit me lajmërim për ekzekutim vullnetar. Pas kësaj shkrese, përmbaruesi privat i është drejtuar Zyrës së Thesarit në datën 10.6.2013 me urdhër për vendosjen e sekuestros konservative. Po ashtu, konstatohet se ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit është vendosur edhe gjobë në shumën 50.000 lekë, për moskryerje të veprimeve në zbatim të titullit ekzekutiv, por kjo gjobë është revokuar në datën 25.9.2013 për faktin se ishin marrë masat ligjore për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

31. Në lidhje me sjelljen e debitorit, Kuvendi i Shqipërisë, Gjykata konstaton se ky autoritet është vënë në dijeni nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, dega Tiranë në datën 10.6.2013 në lidhje me bllokimin e

fondeve buxhetore në artikullin 602 për ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të palës kreditore. Në datën 26.6.2013, Kuvendi është vënë sërish në dijeni për vendosjen e sekuestros konservative në rast se nuk do të procedonte sipas udhëzimit të KM nr. 2, datë 18.8.2011. Në muajin shtator, Sekretari i Përgjithshëm, me urdhrin nr. 4, datë 19.9.2013, ka urdhëruar fillimin e ekzekutimit në llogari të thesarit të vendimit të formës së prerë. Pagesa e detyrimit urdhërohej të bëhej pjesore brenda fondit të planifikuar në zërin “Ekzekutim të vendimeve gjyqësore” të buxhetit të vitit 2013.

32. Gjykata konstaton se debitori ka kaluar në llogarinë e përmbaruesit, për llogari të kërkuesit, detyrimin financiar “kësti i parë” në shumën 200.000 lekë në datën 23.9.2013. Më pas në datat 13.11.2013, 5.12.2013, 15.1.2014, 10.2.2014, 4.3.2014 dhe 2.4.2014 janë likuiduar respektivisht nga 100.000 lekë/muaj. Në datën 22.4.2014 është derdhur edhe kësti i fundit në shumën 86 080 lekë.

33. Në vështrim të rrethanave të mësipërme, Gjykata vlerëson se veprimet e kryerja nga pala debitore krijojnë bindjen se ajo ka pasur vullnetin për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në kushtet kur detyrimi është përmbushur tërësisht, sjellja e autoriteteve është e tillë që tregon vullnet për rivendosjen e të drejtës së cenuar.

34. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm ka sjellë cenimin e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së është i pabazuar dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhet rrëzuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006